

TV debat në Tetovë “Zhvillimi i bashkëjetesës ndëretnike – sfidë për institucionet në Tetovë”

Më 29 shkurt të vitit 2008 me fillim në ora 20.10 në stacionin televiziv lokal Menada u emitua TV debati “Zhvillimi i bashkëjetesës ndëretnike – sfidë për institucionet në Tetovë” në gjuhën maqedonase. Emisionin e udhëhoqi Sandra Sërbinovska, gazetare në TV Menada me përkthim në gjuhën shqipe.

Në debat morën pjesë: Adnan Nuhi – kryetar i Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive në Tetovë, Naser Qamili – këshilltar në komunën e Tetovës, Marina Obadiq – Zëvendës Avokati i Popullit në zyrën rajonale Tetovë dhe Sreten Koceski – kryetar i Institutit për zhvillimin e bashkësive në Tetovë. Qëllimi i TV debatit ishte të promovohet roli i institucioneve që janë kompetente për ti mbrojtur të drejtat e bashkësive etnike jo shumicë, por edhe të diskutohet për punën e Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive, përfaqësimi i drejtë në Komunën e Tetovës, përdorimi i gjuhëve të bashkësive dhe afirmimi ndërkulturor i cili mundet të përdoret si urë për afrimin e përfaqësuesve të përkatësive të ndryshme etnike dhe fetare.

Të gjithë bashkëbiseduesit u pajtuan se implementimi i Kushtetutës dhe ligjeve është mekanizmi i parë dhe themelor që e garanton mbrojtjen e bashkësive etnike jo shumicë. Mes tjerash, në nivel lokal ekzistojnë komisione dhe trupa të ndryshëm të cilët ndihmojnë në avancimin e të drejtave të bashkësive, por rol të rëndësishëm kanë edhe organizatat joqeveritare të cilat duhet ti inkurajojnë shembujt e mirë apo të korrigjojnë disa çështje të caktuara kur nuk funksionojnë sistemet e institucioneve. Në fjalimet e tyre, pjesëmarrësit kishin mundësi ta prezantojnë punën e institucioneve dhe organeve në të cilët punojnë duke krijuar një pasqyrë të përgjithshme për gjendjen e bashkësive etnike jo shumicë në Tetovë.

Konkludimet e përgjithshme të dala nga TV debati ishin: qytetarët nuk janë të informuar për gjendjet në komunë nga aspekti i përfaqësimit etnik; bashkësitë më të vogla janë në pozitë të pavolitshme sepse aksenti kryesisht vendoset në marrëdhëniet mes maqedonasve dhe shqiptarëve; asnjë përfaqësues i bashkësisë turke nuk është i punësuar në komunë; gjuhët e bashkësive më të vogla etnike nuk përdoren në komunë, edhe pse sipas bashkëbiseduesve kjo do të ishte një gjest i shkëlqyer i barazisë për të gjithë; qytetarët nuk i njohin sa duhet gjuhët e bashkësive tjera etnike – institucionet të ndihmojnë në mësimin e gjuhës së “tjetrit”; i vogël është numri i ankesave që dorëzohen te zyra e Avokatit të Popullit; festat fetare janë shkas kur qytetarët me besime të ndryshme shoqërohen dhe shkojnë mysafir te njëri tjetri, por ekziston nevoja për më tepër aktivitete të përbashkëta dhe manifestime të grupeve të ndryshme etnike.

Për qëllimet e kësaj TV debate ishte bërë anketë mes qytetarëve të Tetovës të cilëve u është parashtruar pyetja se çka mendojnë për bashkëjetesën në qytetin e tyre dhe sa institucionet duhet të ndihmojnë në avancimin e bashkëjetesës. Po thuaj të gjithë të anketuarit kanë deklaruar se bashkëjetesa në Tetovë ekziston. Si një nga shkaqet për ndarjet që ekzistojnë mes qytetarëve, bashkëbiseduesit në debat i shohin politikanët, ndërsa mes njerëzve të rëndomtë marrëdhëniet në masë të madhe janë të mira.